

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	626-24-5207-1-2-1
Nr i brendshëm	626-24-008-1-2-1

Sa i përket tenderit për: "Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar" Lot 1 dhe 2.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

MEDPLUS SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Pranvera e Lirisë, p.n, Lebanë

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344640420

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

medplusks@gmail.com

(Adresa elektronike)

09.12.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 21.06.2024
Data e hapjes së ofertave: 01.07.2024
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 04.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Sqarim:

Me dt. 29.07.2024 autoriteti kontraktues e kishte publikuar njoftimin mbi vendimin e parë, ku në këtë vendim ishte anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se janë bërë lëshime në paramasë. Kundër këtij vendimi ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim me dt. 02.08.2024, ndërsa AK-ja me dt. 05.08.2024 na kishte refuzuar kërkesën për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar.

Pastaj ne kemi dorëzuar ankesën në OSHP me dt.14.08.2024, ndërsa në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza nga ekspertja shqyrtuese dhe vendimi i panelit shqyrtues me nr. 2024/0735. Në të dy rastet sikurse në ekspertizë edhe në vendim të panelit shqyrtues ankesa jonë ishte aprovuar si e bazuar dhe ishte detyruar autoriteti kontraktues që të anuloi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Pasi që autoriteti kontraktues nuk ka mundur të arrij qëllimet e saj për ta anuluar aktivitetin e prokurimit, tani në mënyrë tendencioze po mundohet të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit, me arsye krejtësisht të pa bazuara dhe të paqëndrueshme edhe përkundër faktit që ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne me dt.04.12.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetimin si më poshtë

Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit në mbështetje të nenit 43 paragrafi 43.5 pika (b) Anulon aktivitetin e prokurimit në fjalë pasi që nuk ka pasur asnjë operator ekonomik të përgjegjshëm.

ndërsa ne jemi eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Duke u bazuar në Rregulloren për Prokurimin Publik, dispozitat për tenderët Jo-normalisht të ulët, komisioni konstatoi se Operatori Ekonomik MEDPLUS SH.P.K. ka ofruar tender jo normalisht të ulët pasi që i ka përmbyshur të gjitha kushtet e parapara në nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik për tu cilësuar si tender jo normalisht të ulët, andaj komisioni vlerësues ka konstatuar që këtij O.E. ti refuzohet tenderi edhe përkundër që ka ofruar tenderin me çmimin më të ulët sepse nuk ka arritur që të ofroj prova dhe të bind komisionin në lidhje me sqarimin për çmime jo normalisht të ulëta dhe për disa artikuj ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut. Pra ky O.E. ka ofruar çmime manipulative në tenderin e tij.

Gjithashtu nga AK me datë 30.10.2024 duke u bazuar në nenin 30 të Rregullores për Prokurimin Publik, është bërë kërkesa që O.E. MEDPLUS SH.P.K. dhe KONTI SH.P.K. të zgjasin afatin e ofertës dhe sigurimit të tenderit me të cilën është kërkuar nga O.E. në fjalë që përmes një deklarate të deklarojnë se pajtohen me vazhdimin e validitetit të ofertës si dhe të zgjasin vlefshmërinë e sigurimit dhe të ngarkojnë dëshmitë më së largu deri me datën 31.10.2024 ora 14:00. Komisioni i rivlerësimit nga shkresat e lëndës gjeti se O.E. MEDPLUS SH.P.K. kishte dorëzuar deklaratën e validitetit të ofertës pas afatit ligjor të kërkuar në shkresën e datës 30.10.2024 me ç'rast në platformën elektronike, kishte ngarkuar deklaratën për vazhdimin e validitetit me datë 31.10.2024 ora 17:20 ndërsa sigurimin e tenderit me datën 31.10.2024 ora 18:07.

Fillimisht sqarojmë se neve na është kërkuar sqarime me dt.05.11.2024 si në vijim:

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguronit sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:

Në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-s, kërkojmë nga ana juaj të na sjellni sqarim si me poshtë:

Duke analizuar ofertën tuaj në lidhje me tenderin “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar” kërkojmë nga ana juaj që të na jepni informata shtesë në disa artikuj të ofertuar si më poshtë:

- 1. Pozicioni 8. ALAP GPT 4x250ml – Çmimi i kërkuar është për 1 (një) copë 4x250ml. Çmimin që e keni ofruar për këtë pozicion a është për 1 (një) copë apo për kuti.*
- 2. Pozicioni 14. Është kërkuar -Vazhduese për pipeta yellow 1/1000 Humana. A është ofruar çmimi për kuti prej 1000 copë apo vetëm për 1 copë, ku ju keni dhënë çmimin prej 0.06 euro .*
- 3. Pozicioni 15. Është kërkuar - Vazhduese për pipeta blue 1/500 . A është ofruar çmimi për kuti prej 500 copë apo vetëm për 1 (një) copë, ku ju keni dhënë çmimin prej 0.07 euro.*
- 4. Pozicioni 23 - AccuChek lancets 1/25 për 1 (një) copë, për këtë artikull ju keni dhënë çmimin 0.26 euro . Çmimi i dhënë a është për kuti apo për 1 (një) copë.*
- 5. Pozicioni 28 – Oxygen Concentrator 5L- çmimi i ofruar është shumë nën çmimin e tregut, na konfirmoni se çfarë paisje keni ofruar këtu dhe a e konfirmoni se me këtë çmim do furnizoni komplet sasinë e kërkuar prej 2% të vlerës së tenderit (sasia 800 copë).*
- 6. Pozicioni 47 – Shpatulla druri josterile 1/100, çmimi i ofruar nga ana juaj a është për komplet kutin prej 100 cope apo është vetëm për 1 (një) copë.*

Gjithashtu a e konfirmoni që me rastin e porosisë e sjellni komplet materialin sepse nuk e pranojmë liferimin parcial të materialit të kërkuar.

Ju njoftoj se në bazë të nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 59 me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit tuaj, kërkojmë që të na jepni sqarime në lidhje me pozicionet e lartë cekur.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohet prej nesh në adresën e lartë shënuar të autoritetit kontraktues përmes platformës elektronike brenda afatit prej 2 (dy) ditëve nga data e kësaj kërkesë, përkatësisht deri më 07.11.2022 ora 14:00.

Në lidhje me këto sqarime ne kemi kthyer përgjigje me dt.07.11.2024, duke sqaruar në detaje çështjet e ngritura nga AK-së dhe kemi bashkangjitur pro faturën nga Pharma group SHPK që e kemi pasur para se të ofertonim në lidhje me pozicionin 28 Oxygen concentrator 5L dhe për produkte të tjera.

Me dt.12.11.2024 përsëri na kërkohen sqarime si më poshtë:

Ne konsiderojmë që ju në tenderin tuaj në disa pozicione keni vendosur çmime jo-normalisht të ulëta, ndërsa në disa pozicione keni vendosur çmime tepër të larta në krahasim me objektin e kontratës.

Kërkesa:

Në bazë të nenit 61 të LPP-s, Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafi 41.4 kërkojmë që të na jepni sqarim në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të paraqitura në pozicionet e përshkrimit të çmimit, duke saktësuar ekonominë e procesit të furnizimit, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin tuaj për të kryer furnizimet dhe shërbimet e paraqitura në paramasën për procedurën e prokurimit në fjalë. Gjithashtu kërkojmë të na jepni informata shpesh mbi koston e furnizimeve dhe shërbimeve të propozuara, pasi që komisioni i ri-vlerësimit duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura për tenderët jo-normalisht të ulët, ka konstatuar se keni ofruar çmime jo-normalisht të ulëta sipas pozicioneve të përshkruara në

çmimore (paramasë), ndërsa në disa artikuj keni vendosur çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Andaj, kërkojmë që të na dërgoni informatat në lidhje me pozicionet e më poshtme të cilat i kemi ndarë në çmime jo normalisht të ulëta dhe në çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Çmimet jo normalisht të ulëta:

Pjesa A. Pozicionet: 7, 19, 28 dhe 47.

Çmimet tepër të larta:

Pjesa A. Pozicionet: 14, 15, 18 dhe 23.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë të tenderit tuaj, kërkojmë që së bashku me informatat të na dërgoni referencat në të cilat jeni bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve si dhe si dëshmi të na dërgoni **kopje të faturave** së bashku me transfer bankar apo të **kontratave** në të cilat evidentohen artikujt e lartcekur.

Në lidhje me këto sqarime ne kemi dhënë përgjigje me dt.14.11.2024 duke sqaruar në detaje dhe duke ofruar edhe pro faturën nga Pharma group SHPK për çmimet për të cilat ka ngritur dilema AK-së.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar sepse përgjigjet dhe sqarimet tona kanë qenë bindëse dhe me fakte konkrete ku kemi bashkangjitur pro faturat e produkteve.

Për më tepër sqarimet kanë të bëjnë vetëm për Lot 1 dhe nuk kanë të bëjnë me Lot 2, mirëpo AK-së nuk përmend këtë fakt fare, sikurse që e kishte anuluar edhe në herën e parë këtë tender ku nuk kishte të bënte pretendimi i tyre me Lot 2. Këto veprime të AK-së tregojnë më së miri tendencën për të na dëmtuar neve dhe për të mos na shpallur fitues.

AK-ja ka bërë vlerësim subjektiv pasi që sqarimet tona janë bërë konform nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të RRPP-së 001/2022, andaj të njëjtat është dashur të merren parasysh nga ana e AK-së.

Autoriteti kontraktues me dt.30.11.2024 ka kërkuar nga ne që të vazhdojmë validitetin dhe sigurimin e tenderit ndërsa afatin e ka dhënë deri me dt.31.10.2024.

Realisht kërkesa për vazhdim të validitetit është ngritur në sistem me dt.30.10.2024 në ora 08:19 dhe është lënë afati deri të nesërmen me dt.31.10.2024 ora 14:00. Nga këto fakte shihet që 30 orë të plota janë lënë në dispozicion për vazhdim të validitetit dhe sigurimit të tenderit, prandaj ky afat është kundërligjor dhe tendencioz sepse askund në ndonjë dispozitë të LPP-së e as të Legjislacionit sekondar nuk parashihet që mund të jepet një afat për vazhdim të sigurimit prej 30 orëve.

Ne kemi bërë vazhdimin e validitetit dhe të sigurimit me dt.31.10.2024. Vazhdimin e validitetit e kemi bërë në ora 17:20 kurse të sigurimit në ora 18:07.

Te çdo sqarim që kërkohet në rastet e ofrimit të kërkesave të përshtatshmërisë parashihet afati prej pesë ditëve ose në raste të tjera minimumi prej pesë ditëve, e që nga këto fakte kuptohet që operatorëve ekonomik duhet të ju jepet kohë e arsyeshme për të ofruar dëshmitë e kërkuara. Ky afat i shkurtër ndërlidhet me procesin e prokurimit gjatë vlerësimit dhe shpërfaqë tendencën e hapur ndaj kompanisë tonë sepse fillimisht ishte anuluar ky aktivitet i prokurimit, më pastaj janë kërkuar dy herë sqarime shtesë dhe tani në fund jepet afati 30 orë për ofrim të vazhdimit të validitetit dhe sigurimit të ofertave.

Pavarësisht afatit të dhënë për vazhdim të validitetit dhe sigurimit të tenderit, sqarojmë se validiteti i tenderit dhe sigurimi bëhen në ditë të plota dhe nuk bëhen me orë, prandaj vazhdimi i vlefshmërisë së tenderit dhe sigurimit me dt.31.10.2024 është i rregullt dhe sipas legjislacionit për prokurim publik.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me **çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Pra duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **MEDPLUS SH.P.K për Lot 1 dhe 2,**
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.